


NE E RESPEKTOJMË



NJËRI-TJETRIN

DEMOKRACIA ËSHTË . . .

ADMIRIM (13), LORITA (13), ENKLOD (14), SUELA (13), DORUNTINA (13), ENES (13)



Ne mendojmë që një shtet demokratik duhet të investojë në brezat e rinjë, sepse të rinjtë janë e tashmja dhe e ardhmja e një vendi

Siç e dimë, demokracia është një formë qeverisjeje e cila është e pranishme në shumë shtete të botës. Edhe ne jemi pjesë e demokracisë, si shumë shtete të tjera. Demokracia për herë të parë u paraqit në Athinë në vitin 507 p.e.s. Demokracia rrjedh nga fjalët greke „demo“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë rend apo udhëheqje.

Vlerat kyesore të demokracisë janë: liria, barazia, drejtësia, respekti, të drejtat themelore të njeriut dhe shumë vlera të tjera. Të drejtat themelore të njeriut janë: e drejta personale, e drejta civile dhe politike, e drejta sociale dhe ekonomike dhe të drejtat e brezit të tretë. Një e drejtë e cila i prek gjeneratat e reja është e drejta e shkollimit. Këtë të drejtë na e siguron shteti

përmes ndërtimit të shkollave, ofrimit të librave etj. Një të drejtë tjetër që na e siguron shteti është e drejta e punës. Me këtë të drejtë njerëzit e një vendi, jo vetëm ata të cilët janë të kualifikuar, punojnë në profesionet e tyre për ta zhvilluar shtetin. P.sh. ne jemi gazetarë dhe detyra jonë është të informojmë qytetarët. Në të drejtat themelore të një shteti hyjnë edhe të drejtat e fëmijëve. Konventa e të Drejtave të Fëmijëve ka 54 nene. Ka dy forma të demokracisë, demokracia e drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy forma të tjera, ato janë sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial. Kosova është demokraci përfaqësuese parlamentare, sepse populli voton për deputetët në zgjedhjet qendrore. Republika e Kosovës është shtet demokratik dhe besojmë që do të mbetet ashtu gjithmonë edhe me ndihmën e gjeneratave të ardhshme.



Të drejta të barabarta



Autorët e artikullit




Të bashkuar shkojmë përpara



Ne jemi aktiv



Puna jonë është e rëndësishme



Demokracia, fjala e popullit



Ne kemi të drejtën e emrit dhe identitetit

KUVENDI, INSTITUCION I RËNDËSISHËM

BLEONA (13), DRILONI (13), EDUARD (14), LUMI (13), ERDONISI (13), BARDHA (13)

Nëse dëshironi të dini më shumë rreth Kuvendit të Kosovës, lexoni këtë artikull

Në demokraci të gjithë jemi të barabartë. Ligjet na mundësojnë që ne të jemi të barabartë. Propozimet e ligjeve, miratimi apo jo miratimi i tyre bëhet në Kuvend. Kuvendi është organi më i lartë legjislativ i vendit, i cili ndryshe njihet edhe si „Shtëpia e Popullit“.


Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, kurse 20 të tjerë janë të komuniteteve jo shumicë si: romë, ashkali, serb, turk, egjiptian dhe boshnjak.

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi ka edhe dy funksione të tjera, atë kontrollues sepse e mbikëqyr Qeverinë dhe funksionin përfaqësues sepse deputetët përfaqësojnë popullin.

Demokracia na mundëson që ne të shprehim mendimet dhe të bëjmë ndryshime në vendin tonë.



Gazetarët e vegjël



Në këtë vizatim është paraqitur njëra nga mënyrat e votimit, që është votimi i mbyllur



Ndërsa, në këtë vizatim është paraqitur një mënyrë tjetër e votimit, votimi i hapur



Grupi ynë duke biseduar për Kuvendin dhe funksionet e tij



Për të arritur një qëllim duhet të bashkëpunojmë


VLERA E QYTETARIT NË DEMOKRACI

LORION (13), ANITA (13), ANITA K. (13), DONARD (13), AMRI (13), DIANA (13)



Ne jemi qytetarë të Kosovës demokratike dhe si të tillë kemi të drejta dhe përgjegjësi

Secili person, i cili jeton brenda një shteti të caktuar me një leje qëndrimi të vlefshme quhet qytetar i atij shteti. Marrim shembull Rugovën e Pejës. Rugova është vend malor, por edhe atje jetojnë familje të ndryshme. Megjithatë, kjo nuk i bën ata më pak qytetarë sesa të tjerët që jetojnë në pjesë të tjera të Kosovës. Nga kjo



kuptojmë se të gjithë personat që jetojnë në Kosovë dhe kanë leje qëndrim, janë qytetarë të Kosovës. Pse po themi leje qëndrim? E themi sepse në rast se ne shkojmë në një shtet tjetër të botës, atëherë jemi vetëm vizitorë të atij vendi. Nuk jemi qytetarë sepse nuk kemi leje qëndrim për të jetuar aty. E ç'është më e rëndësishmja, nuk jemi të regjistruar në regjistrin civil. Të jetosh në demokraci do të thotë të kesh të drejta. Mirëpo, ne e dimë se me të drejtat vijnë edhe përgjeg-

jësitë. Këto përgjegjësi kërkohen nga ne si qytetarë që t'i kryejmë, në mënyrë që të kemi një shtet sa më demokratik. Këto janë të drejtat tona: e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e votimit, e drejta e shkollimit etj.

Ne kemi të drejtë të shkojmë në shkollë dhe këtë të drejtë e shfrytëzojmë çdo ditë. Megjithatë, përgjegjësi kemi të mësojmë në shkollë, të jemi të sjellshëm, të respektojmë njëri-tjetrin dhe mësimdhënësit, etj.

Nuk duhet të harrojmë se demokracia kërkon që të jemi qytetarë aktiv. E aktiv mund të jemi duke marrë pjesë në tubime të ndryshme publike, duke marrë pjesë në procesin zgjedhor, duke nënshkruar peticione, duke u bërë pjesë e organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijëve dhe të njeriut etj.

Demokracia është sikur lule, nëse e ujisim ajo rritet. Ne jemi ata që e ujisim demokracinë, dhe do ta ujisim atë me dijen, përkushtimin, punën dhe aktivizimin tonë.



Grupi „Zemrat“



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Metush Krasniqi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Rogaqicë, Kamenicë